

BACHELOR NË TURIZËM

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Bachelor në Turizëm
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR, me Vendim nr. 28, datë 07.02.2025
Cikli i studimit	Cikli i parë i studimeve
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti Ekonomik, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqipe
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njëhësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit **Bachelor në Turizëm** është të aftësojë studentët në fushën e turizmit. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

1. Të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre në fushën e turizmit.
2. Të kenë njohuritë e nevojshme për organizmin dhe drejtimin e bizneseve hoteliere, bizneseve ndihmëse të turizmit.
3. Të kenë njohuritë e nevojshme për organizmin dhe drejtimin e zyrave turistike.
4. Të kenë njohuritë e nevojshme për përdorimin e sistemeve elektronike të prenotimit dhe njohuritë praktike në drejtim të shërbimit të turistëve.
5. Të jenë të përgatitur për të vazhduar studimet në ciklin e dytë ose për të hyrë në tregun e punës me një profil profesional të qartë.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit në turizëm.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin e turizmit në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të bazave të turizmit, marketing turistik, menaxhim i shërbimit, ushqimit dhe pijeve etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. Lëndë të formimit të përgjithshëm

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Hyrje në Ekonomi	6
2.	Historia e Ekonomisë	6
3.	Bazat e Turizmit	6
4.	Bazat e Marketingut	6
5.	Menaxhim në biznes	6
6.	Ligje Turizmi	5
	TOTALI	35

2. Lëndë të formimit karakterizues

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Bazat e financës	6
2.	Mikroekonomi	6
3.	Makroekonomi	7
4.	Parimet e Kontabilitetit	6
5.	Kontabiliteti Financiar	7
6.	Manaxhimi i Burimeve Njerëzore	6
7.	Marketingu Turistik	6
8.	Manaxhimi Shërbimit të ushqimit dhe Pijeve	6
9.	Financa Publike	6
10.	Etika e Biznesit	6
11.	Sjellje Organizative	6
12.	Strategjia e Turizmit	6
13.	Drejtimi i Ndërmarrjeve Turistike	6
14.	Drejtimit financiar	7
15.	Hoteleri dhe restoranteri	6
16.	Turizmi kulturor dhe trashëgimia	6
	TOTALI	99

3. Lëndë ndërdisiplinore/ integruese lëndë–nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Matematikë financiare	7
2.	Statistikë	7
3.	Lëndë me zgjedhje (1 nga 3)	5
	1)Shkrim akademik	
	2)Strategji marketingu	
	3)Shkrim dhe menaxhim projektesh	
4.	Lëndë me zgjedhje (1 nga 3)	5
	1)Kontabilitet kosto drejtimi	
	2)Kontabilitet nacional	
	3)Financa personale	
5.	Lëndë me zgjedhje (1 nga 3)	5
	1)Biznes ndërkombëtar	
	2)Investime	
	3)Drejtimit marketingu	
	TOTALI	29

4. Lëndë të formimit plotësues

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Gjuhë e Huaj (Anglisht, Frëngjisht, Italisht)	5
2.	Informatikë	5
	TOTALI	10

5. Përgatitje punim diplome

Nr	Lëndët	Kredite
1.	Provimi formimi/ Punim diplome	7
	TOTALI	7

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë “Bachelor” në *Turizëm* është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë në sektorin e turizmit.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit *Bachelor* në Turizëm mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë në Turizëm, Trashëgimi Kulturor apo në një fushë të ngjashme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia Bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit.

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë /ekspertë në fushën e turizmit. Për këtë arsye synimi i programit të studimit Bachelor në Turizëm është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Ne zyra dhe agjensi turistike
2. Ne resorte te medha turistike
3. Ne restorante dhe biznese catering
4. Ne biznese qe ofrojne sherbime turistike
5. Ne biznese ndihmese turistike
6. Ne sipermarrje private turistike

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit “Bachelor” në Turizëm fitojnë njohuri për sektorin dhe industrinë turistike, organizimin dhe drejtimin e bizneseve hoteliere dhe bizneseve ndihmese të turizmit, organizimin e funksionimit të zyrave turistike, praktikën dhe procedurat me bashkëkohore të shërbimit ndaj turistëve, sistemet elektronike të prenotimit në hotele dhe zyra turistike, format e turizmit, traditat, kulturën, historinë, monumentet e natyrës, dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin turistik të një destinacioni.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Turizëm

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i parë				
1.	Hyrje në ekonomi	6	60	I
2.	Historia e Ekonomisë	5	45	I
3.	Bazat e Turizmit	6	60	II
4.	Bazat e Marketingut	6	60	I
5.	Menaxhim ne Biznes	6	60	I
6.	Matematikë Financiare	7	75	II
8.	Bazat e Financës	6	60	II
9.	Mikroekonomi	6	60	I
10.	Gjuhë e huaj (Anglisht, Frëngjisht, Italisht)	5	60	II
11.	Statistikë	7	75	II
Gjithsej viti i parë		60 ECTS	630	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Makroekonomi	7	75	I
2.	Parimet e Kontabilitetit	6	60	I
3.	Kontabiliteti Financiar	7	75	II
4.	Menaxhimi I Burimeve Njerëzore	6	60	I
5.	Marketing Turistik	6	60	I
6.	Menaxhimi i Sherbimit te Ushqimit dhe Pijeve	6	60	II
7.	Financa Publike	6	60	II
8.	Etika e Biznesit	6	60	II
9.	Informatikë	5	45	I
Lëndë me zgjedhje				
10.	1) Shkrim Akademik	5	45	II
	2) Shkrim dhe Menaxhim Projektesh			
	2) Strategji Marketingu			
Gjithsej viti i dytë		60 ECTS	600	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i tretë				
1.	Ligje Turizmi	6	60	II
2.	Strategjia e turizmit	6	60	II
3.	Drejtimi I ndërmarrjeve Turistike	6	60	I
4.	Drejtimi Financiar	7	75	I
5.	Hoteleri dhe Restoranteri	6	60	II
6.	Sjellje organizative	6	60	I
7.	Turizmi Kulturor dhe trashëgimia	6	60	I
8.	Lëndë me zgjedhje			
	-Kontabilitet Kosto Drejtimi	5	45	I
	- Kontabilitet Nacional			
	- Financa Personale			
9.	Lëndë me zgjedhje			
	-Biznesi Ndërkombëtar	5	45	II
	-Investime			
	-Drejtim Marketingu			
10.	Provim formimi / Punim diplome	7	50	II
Gjithsej viti i tretë		60 ECTS	575	
Total : viti I + viti II + viti III		180 ECTS	1805	